

KPK konfirmon në detyrë gjyqtaren e Gjykatës së Posaçme, Flora Hajredinaj

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi u njoh me shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore nga gjyqtarja Flora Hajredinaj lidhur me mungesë të burimeve financiare dhe një raport negativ të DSIK, vendosi konfirmimin e saj në detyrë.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtarja Flora Hajredinaj. Foto: BIRN

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, KPK shpalli të premtën vendimin për gjyqtaren pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Flora Hajredinaj. Trupi gjykues KPK i përbërë nga Brunilda Bekteshi kryesuese, Olsi Komici relator dhe Firdes Shuli anëtare, njoftuan se vendosën konfirmimin në detyrë të gjyqtares Flora Hajredinaj.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 7 tetor, Komisioni ngriti dyshime për mundësitë financiare të gjyqtares së Gjykatës së Posaçme, Flora Hajredinaj dhe vjehrrit të saj për dhënien e një dhurate prej 40 mijë eurosh që kishin shërbyer për blerjen e një apartamenti.

Hajredinaj shpjegoi në seancë se deri në blerjen e apartamentit kishin jetuar së bashku me prindërit e bashkëshortit dhe kërkoi që mundësia e kursimeve të përllongaritej për të gjithë së bashku. Gjithashtu, ajo i kërkoi KPK që të konsideroheshin edhe të ardhurat nga qiratë e dy lokaleve në Bajram Curri dhe paraqiti si indicie për të vërtetuar marrëdhëniet e qirave një listë të gjatë deklaratesh materiale të personave që i kishin marrë me qira dhe të atyre që kishin punuar aty, të

cilët deklaroi se në dijeninë e tyre lokalet ishin dhënë me qira nga vjehri i Hajredinajt.

Në seancën dëgjimore u debatua edhe mbi dy qëndrime të ndryshme të DSIK që u kundërshtuan nga gjyqtarja Flora Hajredinajt.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.